



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 6948 Prot.

Tiranë, më 28.06. 2018

**URDHËR**

Nr. 354, datë 28.06.2018

**PËR  
HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË  
“ASISTENT ADMINISTRATIV” TË KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 35 dhe 72 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në “Asistent Administrativ”, me tre profile: Asistent i Lartë Administrativ; Asistent i Lartë Kontabël dhe Asistent i Lartë Ligjor që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vjet (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Asistent Administrativ”, nga Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale, në Kolegjin Universitar të Biznesit.
2. Veprimtaria akademike për programin e studimit me karakter profesional në “Asistent Administrativ” fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Kolegji Universitar i Biznesit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar i Biznesit

*Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**LINDITA NIKOLLA**

**MINISTËR**

